



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI KONTRAKTOR
BASHKIA PATOS
SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr _____ prot
2018

Patos, më ___/___/

SHTOJCË NË DOKUMENTET E TENDERIT

Bazuar në ligjin 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 42, pika 2, , dhe në nenin 62 të Vendimit nr.914 datë 29/12/2014”Per miratimin e rregullave te prokurimit Publik”(i ndryshuar), Njësia e Prokurimit me iniciativen e vet vendosi të bëjë modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën me objekt **“Krijim i hapësirave rekreative për fëmijë” dhe me fond limit total 6.783.474(gjashtë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tre mijë e katërqind e shtatëdhjetë e katër)lekë, pa TVSH**, me Nr. REF-90742-10-21-2018

si më poshtëlënë për tu zhvilluar më datë 01.11.2018 ora 11:00.

Nga monitorimi që App po i bën procedurave të prokurimit dhe konkretisht për këtë procedurë ka konstatuar si më poshtë:

1. Në pikën 1 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: Liçensat profesionale te shoqerise lidhur me ekzekutimin e puneve te kontrates , referuar preventivit te puimeve si dhe llojit te punimeve te parashikuara ne te duhet te kete keto pika ne licensen profesionale : .N.P-12 A (Punime te inxhinierise se mjedisit)...

Mbështetur në zërat e punimeve të parashikuara për tu realizuar në Preventiv dhe veprimtaritë konkrete të parashkuara për tu kryer në Specifikimet teknike dhe Relacionin teknik, vlerësojmë se për ekzekutimin e kontratës nuk rezulton asnjë veprimtari/punim (referohuni përshkrimit të mëposhtëm të kategorisë) për të cilin do të ishte i nevojshëm disponimi nga ofertuesi i kategorisë N.P. 12 Punime të inxhinierisë mjedisore. (Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të bazeneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogjeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemimit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karierave dhe mbetjeve inerte.) Duke marrë shkas nga sa më lart, sjellim në vëmendje të AK që në hartimin e kritereve për

kategoritë e licencës profesionale të mbajë në konsideratë përcaktimet e pikës 1 të nenit 46, të LPP, dhe pikës 5 të nenit 26, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, që kriteret të jenë në përputhje dhe të lidhura ngushtë me natyrën e kontratës, si dhe përputhshmërinë ndërmjet përshkrimit të kategorive në VKM nr.42, datë 16.01.2008 dhe punimeve që janë parashikuar për realizimin e kontratës së punës publike që prokurohet.

2. Në pikën 2 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: *“Deshmite per mjetet e pajisjet teknike, qe ka ne dispozicion apo mund ti vihen ne dispozicion operatorit ekonomik, qe nevojiten per ekzekutimin ekontrates. ...Bobcat...”*

Sugjerojmë AK, që të shmangë përdorimin e markës së mjetit, pasi ky përcaktim kufizon pjesëmarrjen e OE që disponojnë me dokumentacion minifadrome të markave të tjera, të cilat kryejnë të njëjtin funksion me atë që kërkohet dhe për përshkrimin e mjetit konkret ekzistojnë mënyra të tjera përcaktimi.

3. Në pikën 10 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: *Operatoret ekonomik duhet te japin nje deklarate ku te vertetojne qe gjithe drejtuesit teknik qe figurojne ne licencen e tij , nuk jane te dypunesuar ose jane ne kundershitim me statusin e nenpunesit civil, kjo konform edhe vendim Nr. 759, datë 12.11.2014 për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim.*

Autoriteti kontraktor rezervon te drejten qe te kontrolloje ne cdo kohe, mbi mardheniet e punes te drejtuesve teknik te operatoreve ekonomik.

Në lidhje me vendosjen e këtij kriteri, sqarojmë AK se:

- Referimi në VKM nr.759, datë 12.11.2014 *“Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”* (ndryshuar me VKM nr.943, datë 28.12.2016, nuk është i saktë. Kjo për faktin se legjislacioni i cituar i përket licencimit në fushën studim e projektim dhe mbikëqyrje e koladim në ndërtim dhe jo fushës së zbatimit në ndërtim të cilës i përket veprimtaria e objektit të kontratës që prokurohet në këtë rast.

- Pavarësisht referencës së gabuar, AK duhet të mbajë në konsideratë se legjislacioni në fuqi në fushën e ndërtimit (Ligji nr.8402, DATE 10.9.1998, i ndrytshuar dhe aktet nënligjor në zbatim të tij) dhe licencimit të subjekteve në fushën e zbatimit në ndërtim (VKM nr.42, datë 16.01.2008, i ndryshuar), përcakton specifikisht kriteret mbi bazën e të cilave subjektet (OE) licencohen në këtë fushë dhe mekanizmat e zbatimit dhe monitorimit në fushën e ndërtimit, përfshirë këtu dhe statusin e punësimit të drejtuesve teknik.

Për rrjedhim të sa më lart, vlerësojmë se disponimi nga OE i dokumentit të licencës profesionale të vlefshme, të kërkuar nga AK në pikën 10 të Kapacitetit teknik, është dëshmi e mjaftueshme për të vërtetuar përmbushjen, ndër të tjera, dhe të kushtit të mospatjes së punëmarrjes tjetër publike.

Për sa më sipër Njësia e Prokurimit vendosi të bëj nje argumentim të kritereve të kërkuara në Dst nëpërmjet hartimit të një shtojce:

1. Në pikën 1 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: Liçensat profesionale te shoqerise lidhur me ekzekutimin e puneve te kontrates , referuar preventivit te puimeve si dhe llojit te punimeve te parashikuara ne te duhet te kete keto pika ne licensen profesionale : ...N.P-12 A (Punime te inxhinierise se mjedisit)..**HIQET Licensa N.P.12(Punime te inxhinierise mjedisore).**

2. Në pikën 2 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: “Deshmite per mjetet e pajisjet teknike, qe ka ne dispozicion apo mund ti vihen ne dispozicion operatorit ekonomik, qe nevojiten per ekzekutimin ekontrates. ...Bobcat

Bëhet Minieskavator cope 1.

3. Në pikën 9 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim nga prodhuesi dhe Çertifikatën e Cilësisë për zërat në preventiv, objekt prokurimi (Boja e perdorur,materialet si dhe materialet e perdorura per lodrat e femijeve). Per produktet e perdorura , tabela, bojerat etj , prodhuesi duhet te jete i pajisur me certifikaten ISO 14001-2015 , per mbrojtjen e mjedisit dhe per te vertetuar qe keto produkte jane te pademshme per mjedisin ku do te aplikohen.

- Në nenin 46, pika 2 të LPP parashikohet se: “Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organet e pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuar atë cilësisë”.

- Në nenin 30 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 parashikohet se: “AK për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë .

Ne lidhje me kete pike prodhuesi /distributori duhet te jene te pajisur me certifikata cilesie ne rastin kur ofertuesi nuk eshte prodhues /distributor per zerat ne preventiv objekt prokurimit.

Ky kriter nuk peson ndryshim.

4. Në pikën 10 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: Operoret ekonomik duhet te japin nje deklarate ku te vertetojne qe gjithe drejtuesit teknik qe figurojne ne licensen e tij , nuk jane te dypunesuar ose jane ne kundershtrim me statusin e nenpunesit civil, kjo konform edhe vendim Nr. 759, datë 12.11.2014 për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim.

Autoriteti kontraktor rezervon te drejten qe te kontrolloje ne cdo kohe, mbi mardheniet e punes te drejtuesve teknik te operoreve ekonomik **HIQET Deklarata nga DST**

Bazuar në ligjin 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”,i ndryshuar, neni 42 pika 2/1 ne nenin 62 te Vendimit nr.914 date 29/12/2014”Per miratimin e rregullave te prokurimit Publik”(i ndryshuar)” data e zhvillimi te tenderit do te shtyhet si me poshte:

Data e zhvillimit të tenderit 07.11.2018 ora 11:00 vendi: Prokurim elektronik

www.app.gov.al

Afati i fundit për pranimin e dokumentave, data: 07.11.2018 ora : 11:00 vendi :
Prokurim elektronik www.app.gov.al

Kjo shtojcë do të bashkëngjitet dokumenteve të tenderit dhe do të vihet në dispozicion edhe në rrugë elektronike.

SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE

**Daniela KUKAJ
NIKOLLA**

Florian KITA

Mitjon



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI KONTRAKTOR
BASHKIA PATOS
SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE**

Nr _____ prot

Patos, më ___ / ___ / 2018

Lënda : Kërkesë për pezullim procedure

Administratorit të Sistemit të Prokurimit Elektronik

Znj. Rajmonda Balilaj

Njesia e Prokurimit, më datë 14.08.2018 , ka hartuar një shtojcë në dokumentat e tenderit me objekt objekt **“Krijim i hapësirave rekreative për fëmijë”** Në këto kushte bazuar në Udhëzimin nr. 01 datë 31.01.2012 “Për një shtesë në Udhëzimin nr.03 datë 26.05.2011“Për pezullimin e procedurave të prokurimit në sistemin elektronik” kërkoj që të bëni pezullimin e kësaj procedure në mënyrë që të ngarkohet në sistem shtojca e hartuar.

Spektori i Prokurimeve Publike
Daniela KUKAJ

